



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

VENDIM Nr. 21 datë 09.03.2011

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR FURNIZIMIN ME UJË TË  
PIJSHËM DHE PËR KANALIZIMET NË ZONËN E SHËRBIMIT TË  
SH.A UJESJELLËS-KANALIZIME KORÇË"**

Në mbledhjen e datës 09.03.2011, të Asamblesë të Aksionarëve të Sh.A UKKO,  
Këshilli i Bashkisë së Qytetit Korçë, në zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për  
tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe të VKM Nr.1304, datë 11.12.2009 "Për miratimin e  
modelit të Rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të  
ujesjellës-kanalizimeve sh.a.", pasi u njoh me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë  
Nr. 12 mb 10/04, datë 24.12.2010 dhe pasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e Rregullores për  
furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizimet të dërguar me shkresë nga Drejtoria e Sh.A  
UKKO,

**VENDOSI**

1. Të miratojë Rregulloren "Për furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të Sh.A Ujës-jellës Kanalizime Korçë", bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**GJERGJI PENDAVINJI**